

LIGJ
Nr.8421, datë 28.10.1998

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7602, DATË 9.9.1992 "PËR GARDËN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8361, DATË 1.7.1998**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7602, datë 9.9.1992 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8361, datë 1.7.1998, neni 3 ndryshohet si vijon:

"Presidenti i Republikës ruhet edhe 4 vjet pas lirimit nga funksioni, kurse Kryetari i Kuvendit Popullor dhe Kryetari i Këshillit të Ministrave ruhen edhe 2 vjet pas lirimit nga funksioni i tyre.

Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit të Rendit Publik, përcakton kohën dhe mënyrën e ruajtjes së zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë, parashikuar në nenin 2 pika b të këtij ligji, gjatë ushtrimit të detyrave ose deri në 2 vjet pas mbarimit të funksionit të tyre.

Personalitetet e larta të përmendura në paragrafët e mësipërm nuk merren në ruajtje në rastet e shkarkimit, të lirimit dhe të dorëheqjes së tyre nga funksioni përkatës, për shkak se kanë shkelur dispozitat kushtetuese apo kanë kryer vepra të tjera penale."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me shpalljen e tij nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2249, datë 3.11.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani